23. HC Treske 2	-	-	-	-	-	599,346.00	244,605.00	-
24. HC Voskopoje	-	-	-	-	-	233,434.00	113,215.00	-
25. HC Nikolice	-	-	-	-	-	835,352.00	202,109.00	-
26. HC Rajan	-	-	-	-	-	413,169.00	252,044.00	-
27. HC Barmash	-	-	-	-	-	431,408.00	185,299.00	-
totali zona Korce	-	-	-	-	-	**4,212,752.00**	**2,072,206.00**	-
28. HC Ujanik	-	69,439.37	12,151.92	-	-	55,896.23	55,896.00	-
29. HC Corovode	-	87,414.81	15,297.85	-	-	74,364.14	74,364.14	-
totali zona Berat	-	**156,854.18**	**27,449.77**	-	-	**130,260.37**	**130,260.14**	-
30. HC Borsh	-	2,048,000.00	293,843.48	256,300.00	22,977.00	-	-	-
31. HC Piqeras	-	1,341,000.00	192,404.35	200,000.00	16,000.00	-	-	-
32. HC Leshnice	-	2,496,837.00	358,239.98	649,063.00	58,415.67	-	-	-
totali zona Sarande	-	**5,885,837.00**	**844,487.81**	**1,104,363.00**	**99,392.67**	-	-	-
33. HC Smokthine	-	75,801,830.77	13,265,320.38	47,965,293.15	10,279,740.81	31,985,554.95	30,665,660.22	-
totali nj.t.l. Fier	-	**75,801,830.77**	**13,265,320.38**	**47,965,293.15**	**10,279,740.81**	**31,985,554.95**	**30,665,660.22**	-
TOTALI HK	-	**113,602,088.92**	**21,556,530.89**	**51,786,902.29**	**11,734,444.38**	**36,771,800.39**	**33,100,019.04**	-
HV	**292,000.00**	**12,957,538.99**	**2,697,528.20**	**1,892,123.54**	**1,657,505.68**	**930,289.05**	**780,715.05**	
gjithsej HK+HV	**292,000.00**	**126,559,627.91**	**24,254,059.09**	**53,679,025.83**	**13,391,950.06**	**37,702,089.44**	**33,880,734.09**	

Ekspert Kontabel FLUTURA LUKA TIRANE ALBANIA

Ekspert Kontabel / Autorizuar NEXHMIJE GELA TIRANE ALBANIA

amortizimi	inventar.ek.	amortizimi	dif .rivler	detyrime per amortizimin	kapitali
-	-	-	644,674.56		903,355.46
-	-	-	-		247,749.15
-	-	-	(1,076,915.95)		1,324,665.10
-	-	-	(4,218,804.02)		5,584,205.60
-	-	-	**(4,651,045.41)**		**8,059,975.51**
-	-	-	(2,373,473.00)		2,859,040.34
-	-	-	(4,326,247.72)		5,237,724.29
-	-	-	(3,677,128.80)		4,497,286.12
-	-	-	(3,419,785.00)		3,422,250.29
-	-	-	(4,955,600.00)		4,972,112.49
-	-	-	**(18,752,234.52)**		**20,988,413.53**
-	-	-	(7,173,987.00)		8,383,095.45
-	-	-	(13,778,576.00)		15,415,931.80
-	-	-	(3,616,411.00)		4,422,277.49
-	-	-	4,431,319.00		1,755,877.77
-	-	-	1,441,237.00		2,782,026.36
-	-	-	(1,163,541.00)		1,421,056.17
-	-	-	(989,590.00)		1,201,779.49
-	-	-	3,595,604.00		2,128,381.03
-	-	-	**(17,243,945.00)**		**37,510,405.56**
-	-	-	(2,321,499.00)		2,326,039.00
-	-	-	(293,860.00)		365,002.00
-	-	-	627,441.00		(78,034.00)
-	-	-	(503,246.00)		857,987.00
-	-	-	125,434.00		(5,215.00)
-	-	-	(10,151,625.00)		10,784,868.00
-	-	-	(1,030,010.00)		1,191,155.00
-	-	-	(846,416.00)		1,092,525.00
-	-	-	**(14,393,781.00)**		**16,534,327.00**
-	-	-	(549,665.00)		606,952.68
-	-	-	(723,821.00)		795,937.96
-	-	-	**(1,273,486.00)**		**1,402,890.64**
-	-	-	-		1,986,479.52
-	-	-	-		1,330,595.65
-	-	-	-		2,729,244.35
-	-	-	-		**6,046,319.52**
-	11,222.25	11,222.25	(117,727,242.00)		219,269,199.46
-	**11,222.25**	**11,222.25**	**(117,727,242.00)**		**219,269,199.46**
-	**11,222.25**	**11,222.25**	**(174,041,733.93)**	-	**309,811,531.22**
					10,936,202.65
-	**11,222.25**	**11,222.25**	**(174,041,733.93)**	-	**320,747,733.87**
			(174,041,000.06)	**sistemim 733.87**	**320,747,000.00**

320,747,733.87

Eksperte Kontabël FLUTURA LUKA TIRANË ALBANIA

Ekspert Kontabël i Autorizuar ΣKA NEXHMIJE ÇELA audit TIRANË ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr 691 Date 17.09.2008

PER

NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A "OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES " TIRANE

Drejtuar: SH.A "OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES" TIRANE

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", me cilesine e aksionerit te vetem te Sh.a "Operatori i Sistemit te Shperndarjes " Tirane,

URDHEROJ:

1. Kapitali Themeltar te zvogelohet per vleren 54 411 983 leke , i barabarte me 54 411.9 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali Themeltar i shoqerise behet 15 778 733 906 leke, i barabarte me 15 778 733.9 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
3. Keto ndryshime te behen ne aktet e themelimit te shoqerise.
4. Bazuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqerise " Operatori i Sistemit te SHperndarjes" Tirane, per kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet perkatese ne rregjister.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

GENC RULI

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES TIRANE

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: Kshiretari@mete.gov.al
Internet: http://www.mete.gov.al
Tel: +355 4 226241
Tel: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr.481 Date 28.05.2009

PER

NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A "OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES " TIRANE

Drejtuar: SH.A "OSSH" TIRANE

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare", si dhe VKM-se Nr. 218 date 06.03.2009 " Per disa shtesa ne VKM-ne Nr. 862 date 20.12.2006 "Per krijimin e shoqerise " Operatori i sistemit te Shperndarjes" te ndryshuar, me cilesine e aksionerit te vetem te Sh.a "OSSH" Tirane,

URDHEROJ:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren 7 434 081 000 leke, i barabarte me 7 434 081 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali Themeltar i shoqerise behet 30 099 101 000 leke, i barabarte me 30 099 101 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
3. Keto ndryshime te behen ne aktet e themelimit te shoqerise.
4. Bazuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqerise " OSSH" Tirane per kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet perkatese ne rregjister.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

GENC RULI

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: Kabinet@mete.gov.al
Internet: http://www.mete.gov.al
Tel: +355 4 226241
Tel: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES TIRANE

OSSH TE ARKIVIMIT Nr 1976 30.03.09

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

URDHER

Nr.274 Date 27.3.2009

PER

NDRYSHIMIN E KAPITALIT TE SH.A "OSSH" TIRANE DHE KESH TIRANE

Drejtuar: Sh.A "Operatori i Sistemit te Shperndarjes" Tirane
Sh.A "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" Tirane

Ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe VKM-se Nr. 218 date 06.03.2009 " Per disa shtesa ne VKM-ne Nr. 862 date 20.12.2006, "Per krijimin e shoqerise "Operatori i sistemit te Shperndarjes", sha, te ndryshuar, me cilesine e aksionerit te vetem te sh.a "OSSH" Tirane dhe Kesh Tirane,

URDHEROJ:

1. Sistemimin e kapitalit te Sh.A "OSSH" Tirane dhe Sh.A "KESH" Tirane, per reflektimin e veprimeve kontabile, bazuar ne VKM-se Nr. 218 date 06.03.2009 " Per disa shtesa ne VKM-ne Nr. 862 date 20.12.2006, "Per krijimin e shoqerise "Operatori i sistemit te Shperndarjes", sha, te ndryshuar,
2. Ekspertet Kontabel te Autorizuar Z. Neqifor Rexha dhe Zj. Anita Pulaj, te pergatisin raportin perkates ne perputhje me piken 1 te ketij urdheri.
3. Ngarkohet per zbatimin e ketij urdheri Drejtoria e Sh. A. " OSSH " Tirane dhe Drejtoria e Sh.A "KESH" Tirane.

Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI

GENC RULI

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: Kabinet@mete.gov.al
Internet: http://www.mete.gov.al
Tel: +355 4 226241
Tel: +355 4 223158
Fax: +355 4 234052

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRISË

URDHËR

Nr. 403 datë 06-12- 2016

PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "OPERATORI I SHPËRDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE" SH.A TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9910, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe shkresës Nr. 415/15, datë 17.06.2016 " Miratim Raporti i audituesit të pavarur" , me cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë " Operatori i Shpërdarjes së Energjisë Elektrike" Sh.A Tiranë;

URDHËROJ

1. Kapitali Themeltar i shoqërisë të zvogëlohet për vlerën 15 752 000 lekë, i barabartë me 15 752 aksione me vlerë nominale 1 000 lekë secila, që i përket pakësimit të aktiveve afatgjatë në zërin "Tokë".
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 30 083 349 000 lekë, i barabartë me 30 083 349 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Zvogëlimin e rezervave të tjera për vlerën 361 lekë që i përket diferencës së pakësimit të aktiveve afatgjatë në zërin "Tokë".
4. Rezerva të tjera bëhet 2 916 010 454 lekë pas zvogëlimit .
5. Këto ndryshime të reflektohen në aktet e themelimit të shoqërisë.
6. Bazuar në Ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për rregjistrimin e biznesit" i ndryshuar, ngarkohet Drejtoria e Shoqërisë " Operatori i Shpërdarjes së Energjisë Elektrike" Sh.A Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE OSHEE SH.A. OSHEE, sh.a. Sekretaria Nr. 002

TIRANË

OSHEE sh.a

RAPORT ZVOGELIM KAPITALI

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR

Eneida Rahmani (Saliaj)

Eneida Saliaj (Rrahmani) Lic.Nr. 158

Tirane, 20.05.2016

PERMBAJTJA

- *Raporti i Ekspertes Kontabel te Regjistruar*
- *Pasqyrat financiare te vitit 2014*

Eneida Saliaj
(Haliçani)
Lic. Nr. 158

RAPORT
I AUDITUESIT TE PAVARUR

PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT TE REGJISTRUAR TE SHOQERISE « OSHEE » sh.a

OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE SH.A

Drejtuar: Ministrise se Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarjes

Shoqerise « OSHEE » sh.a
Tirane

Me cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar, te caktuar me Urdherin Nr. 257/1 date 29/01/2016 , te Ministrit te Zhvillimit Ekonomik, Turizmit ,Tregtise dhe Sipermarjes, kemi kryer proceduren per pergatitjen e dokumetacionit per zvogelimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise.

Baza ligjore per realizimin e ketij misioni eshte:

- Ligji Nr. 7850, date 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- Ligji Nr. 9228, date 29/04/2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare".
- Ligji Nr. 10091, date 05/03/2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar"
- Ligji Nr. 9723, date 05/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
- Urdhri Nr. 257/1 , date 29/01/2016 i Ministrit te Zhvillimit Ekonomik, Turizmit , Tregtise dhe Sipermarjes.

Uneida Sallaj
(Rrahmani)
Liç.Nr. 158

Pergjegjesia e drejtimit te shoqerise « OSHEE » sh.a eshte : Pergatitja dhe paraqitja e drejte e deklarimeve financiare, juridike dhe informacioneve te tjera te domosdoshme per dhenien e sigurise se procesit te zvogelimit te kapitalit te shoqerise.

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi Zvogelimin e kapitalit te Shoqerise « OSHEE » sh.a, per vlerat te dala si rezultat i:

1. **Zbritjes nga inventari i Shoqerise i Pasurise se regjistruar me numer 6/443 per vleren 15,752,361 leke.**

Shoqeria « Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike » sh.a eshte regjistruar ne daten 10/12/2007 , si Shoqeri Aksionere , me seli Njesia bashkiake Nr.5 ,Rruga "Andon Zako Cajupi " ,Pallati Conad , kati 3 , Tirane , me kapital te regjistruar deri ne daten e hartimit te ketij raport ne vleren 30 099 101 000 leke, me aksioner te vetem Ministrine e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit ,Tregtise dhe Sipermarjes.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte "Te ofroje energji elektrike nepermjet rrjetit te shperndarjes per fushat e meposhtme te mbuluara: kryerja e veprimtarive te nevojshme dhe te drejtperdrejta te lidhura me blerjen dhe shitjen e energjise elektrike, per furnizimin e klienteve tarifore te lidhur me rrjetin e saj te shperndarjes, me tarifa te rregulluara ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe licensen e akorduar. Kryerja e veprimtarive te nevojshme dhe drejtperdrejt te lidhura me funksionimin e rrjetit te shperndarjes, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe licensen e akorduar, duke perfshire, por pa u kufizuar ne: ndertimin, funksionimin dhe pronesine e rrjetit te shperndarjes se energjise elektrike per sigurimin e energjise elektrike klienteve. Lidhjen e klienteve dhe perdoruesve te rrjetit te shperndarjes se energjise elektrike dhe instalimin dhe sherbimet e matjes se energjise elektrike. Zhvillimi i rrjetit te shperndarjes se energjise elektrike ne perputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe bazuar ne ndryshimet rajonale apo territoriale te kerkeses. Sherbime te tjera per klientet, qe jane te nevojshme per te permbushur detyrimet ndaj tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Gjithashtu, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe licensat e Shoqerise te leshuara nga autoritetet kompetente, Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi, apo qe ndervaret ose lidhet me aktivitetet e renditura me siper. Per arritjen e qellimit te mesiperm, Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari dhe sherbim si per shembull veprimtari tregtare, financiare, arsimore, marketingu, qiradhenie apo hipotekimi, qe mund te konsiderohen te dobishme apo te nevojshme per realizimin e objektit te aktivitetit te Shoqerise.".

Raportin e zvogelimit te kapitalit e mbeshtesin ne Pasqyrat Financiare te vitit 2014.

Gjate ketij procesi nuk eshte marre parasysh rezultati i i shoqerise per periudhen e vitit 2015, pasi eshte ne vazhdimesi dhe Pasqyrat Financiare te Shoqerise per vitin 2015 nuk jane depozituar prane QKR .

Enejda Sakaj (Krahmani)
L.Ş.Nr. 158

Ne Pasqyrat Financiare te Shoqerise per periudhen 01/01/2014 deri ne 31/12/2014 , Grupi Kapitali dhe Rezerva te disponueshme per aksioneret i shprehur ne 000/ leke eshte i perbere si me poshte:

- Kapitali i regjistruar..... 30,099,102 leke
- Rezerva te tjera ..... 2,916,011 leke
- Humbje te akumuluara ..... (99,752,983) leke
- Te ardhura neto vjetore .....(4,510,485) leke
- **Totali i kapitalit.....(71,248,355) leke**

I. Zvogelimi i kapitalit te " OSHEE " sh.a

Ne zbatim te urdherit nr. 257/1 date 29/01/2016 kapitali i shoqerise zvogelohet per vleren e objekteve te Ish Filialit Elektromekanik , ne rrugen "Ali Demi ".

Zvogelimi i kapitalit per:
1.Vlera e aseteve te Ish Filialit Elektromekanik , ne rrugen "Ali Demi ".

Ne kontabilitetin e shoqerise ky objekt eshte i regjistruar me Emertimin " Toka- NKEM " , me numer identifikimi 311010003475 , me numer serial L3851., me date kapitalizimi 01/05/2009 dhe me nje siperfaqe 5,384 m2.

Shoqeria disponon
Kartele te Pasurise se Paluajtshme
Nr Pasurie 6/443 Vol 20 Faqe 75

Siperfaqe totale e pasurise	Nga Sip totale	**Sa Truall**	Nga Siperfaqa Truall	**sa Ndertese**
1	4,170 m2	4,170 m2		1,696 m2

Ne shkresen numer 8438 prot , date 05/05/2016 , te Departamentit Ekonomik te Operatorit te Shperndarjes se Energjise Elektrike sh.a , ne paragrafin e trete para fundit te faqes numer dy thuhet :
'Siperfaqa prej 4,170 m2 toke dhe 1,696 m2 ndertese me numer pasurie 6/443 , sipas vendimeve te mesiperme duhet te hiqet nga inventari I Shoqerise OSHEE sh.a . Kjo siperfaqe sipas relacionit te Drejtorise Ligjore ka ne perberje te saj dhe ndertese , por per shkak te migrimit te te dhenave ne regjistrin kontabel ne date 01/05/2009 , regjistrimit te pasurise ne ZVRPP ne date 21/07/2012 dhe te mos rivleresimit te aseteve te shoqerise mbas regjistrimit ne ZVRPP , nuk eshte bere ndarja e pasurive ."

Ne kete shkrese ne faqen numer tre ne paragrafin e pare thuhet :
" Per vleresimin e siperfaqes qe do te hiqet nga inventari i shoqerise OSHEE sh.a , do te perdoret metoda e cmimit mesatar per njesi . Vlera totale e asetit me numer identifikimi 311010003475 dhe emertim " Toka - NKEM " eshte 20,338,300 leke . Siperfaqa 5,384 m2 . Cmimi mesatar 3,777.54 leke per m2. Vlera e pasurise 6/443 qe do te hiqet nga inventari i OSHEE sh.a eshte : (4,170 m2 x 3,777.54 leke) = **15,752,360.96 leke ."**

Eneida Salaj (Grahmoll) Lic.Nr. 158

Per efekt te rrumbullakosjes se shifres se kapitalit, kapitali aksionar zvogelohet per 15,752, 000 leke, shuma per 361 leke kalojne ne zvogelimin e rezerves, ne rezerva te tjera.

Ne total kapitali aksionar i shoqerise zvogelohet per:

- **Vleren e objektit te regjistruar ne numrin e pasurise 6/443 (Zona Kadastrale 8180 , Vol 20 Faqe 75) 15,752,000 leke**

Ne kontabilitetin e shoqerise ky veprim do te pasqyrohet si me poshte :

Paksim te llogarise « Aktiveve afat gjata materiale » ne zerin toke per	15,752,361 leke
Paksim te llogarise « Kapitali i regjistruar » per shumen	15,752,000 leke
Paksim te llogarise « Rezerva te tjera »	361 leke

Kapitali aksionar i shoqerise do te zvogelohet per 15,752,000 leke

Kapitali i regjistruar i shoqerise " OSHEE" sh.a Tirane para ketij misioni sipas Ekstraktit te Qendres Kombetare te regjistrimit te Bizneseve QKR eshte 30,099,101,000 leke, me 30,099,101 aksione me vlere nominale 1.000 leke secila.

Kapitali i regjistruar i shoqerise, zvogelohet per 15,752,000 leke.

Efekti i ndryshimeve te kapitalit te regjistruar eshte si me poshte:

- **Kapitali i regjistruar para zvogelimit..... 30,099,101,000 leke**
- **Kapitali i regjistruar zvogelohet per ..... (15,752,000) leke**
- **Kapitali i regjistruar pas zvogelimit ..... 30,083,349,000 leke**

Llogarite e kapitalit qe preken nga ky veprim jane :

EMERTIMI	NJESIA	ISHTE	ZEVOGLOHET	BEHET
Kapitali Aksionar	Leke	30,099,101,000	15,752,000	30,083,349,000
Rezerva te tjera	Leke	2,916,010,815	361	2,916,010,454

EKSP. Emeida Saliaj (Krahmani) LIÇ.Nr. 158 UAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise " OSHEE " sh.a Tirane pas zvogelimit eshte 30,083,349,000 leke cili perbehet nga 30,083,349 aksione me vlere 1,000 leke secila.

Ky kapital zoterohet 100% nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit , Tregtise dhe Sipermarjes.

Ne perfundim te misionit qe na eshte caktuar, duke kryer te gjitha ekzaminimet e nevojshme, pasi verifikuam te gjitha procedurat per zvogelimin e kapitalit raportojme se e kemi plotesuar kete detyre sipas kerkesave ligjore ne fuqi.

Sipas opinionit tone jane zbatuar te gjitha kerkesat e Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" per ndryshimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise.

Ky raport mbahet ne 4 (kater) kopje te njejta.

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Eneida Rahmani (Saliaj)

Eneida Saliaj (Rahmani) Lic.Nr. 158

Tirane me 20/05/2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

VENDIM

Nr. 8292/9 **. Datë** 11.07 **2018**

"MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË OSHEE SH,A" TIRANË"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 10.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Nenit 13.2 gërma (i) të statutit të shoqërisë OSHEE sh.a, Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 9. datë 24.05.2018, dhe relacionit shoqërues Nr.1, datë 14.05.2018 dërguar nga shoqëria me shkresë Nr 9818/1, datë 29.09.2018, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë OSHEE sh.a,

VENDOSI:

1. Kapitali Themeltar të zvogëlohet për shumën 146,633,004 lekë, i barabartë me 146,633 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila, për vlerën e aseteve të shoqërisë OSHEE sh.a që i transferohen shoqërisë OST sh.a .
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë pas zvogëlimit bëhet 29,936,715,996 lekë i barabartë me 29,936,716 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, ngarkohet shoqëria OSHEE sh.a, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI

Damian Gjiknuri

OSHEE, sh.a.
Sekretaria
Nr. 002

KËSHILLI MBIKQYRËS
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A
TIRANË

VENDIM

Nr. 9 .datë 24.05.2018

"MBI
MIRATIMIN E RAPORTIT TË EKSPERTIT PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË OSHEE SHA"

Në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjin 43/205 "Për sektorin e energjisë elektrike", Neni 16, pika 3, gërma (m), Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2014 "Për kontabilitetin dhe faturat financiare", Ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin financiar të aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", Statutin të shoqërisë OSHEE sh.a, neni 13.2 pika (i), 16.2 (c), Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 18 datë 10.05.2016, Vendimit të Aksionarit Nr. 1320/4 datë 03.03.2017, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga OSHEE sh.a me Relacionin Nr. 1, Nr. 8974/1 Prot. datë 14.05.2018, në mbledhjen e datës 24.05.2018,

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të Audituesit Ligjor Z. Bujar Bendo për Zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë OSHEE sh.a, në vlerën 146,633,004 lekë (njëqindedyzetëegjashtëmijë e gjashtëqindetridhjëtëetremijë e katër lekë), sipas vlerës kontabël neto në datë 31.03.2018, të aseteve të shoqërisë OSHEE sh.a që tranferohen te shoqëria OST sh.a.

2. Paraqitjen e këtij vendimi për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë OSHEE sh.a për ndjekjen e procedurave për zbatimim e këtij vendimi dhe paraqitjen e tij për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKQYRËS
ILIR BEJTJA

ENTELA ÇIPA
ANËTAR

AGIM BREGASI
ANËTAR

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A. OSHEE, sh.a. Sekretaria Nr. 002

TOMMY KOLA
ANËTAR

ENEA KARAKAÇI
ANËTAR

ENTON DURO
ANËTAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

VENDIM

Nr. 8282/1. Datë 11.07 2018

"MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË OSHEE SH,A" TIRANË"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 10.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Nenit 13.2 gërma (i), të statutit të shoqërisë OSHEE sh.a, Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 12. datë 24.05.2018 dhe relacionit Nr.4, dërguar nga shoqëria me shkresë Nr.9812/1, datë 29.09.2018, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë OSHEE sh.a,

VENDOSI:

1. Kapitali Themeltar të zvogëlohet në shumën prej 6,996 lekë, për vlerën e Kabinës Elektrike Dajti 1, në rrugën "Kongresi i Manastirit" .
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë pas zvogëlimit bëhet 29,936,709,000 lekë i barabartë me 29,936,709 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, ngarkohet shoqëria OSHEE sh.a, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI

Damian Gjiknuri

OSHEE, sh.a.
Sekretaria
Nr. 002

KËSHILLI MBIKQYRËS
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A
TIRANË

VENDIM
Nr. 12. datë 24.05.2018

"MBI
MIRATIMIN E RAPORTIT TË AUDITUESIT LIGJOR Z. ELTON TIRANA, PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALITTË SHOQËRISË OSHEE SH.A,"

Në mbështetje të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenin 16.2 (c), 16.3 (o), nenin 13.2 (i) të Statutit të Shoqërisë së Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë OSHEE sh.a pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Administratori i shoqërisë në Relacionin Nr. 4, Nr. 8974/4 Prot. datë 14.05.2018, në mbledhjen e datës 24.05.2018,

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit e Audituesit Ligjor Z. Elton Tirana, për Zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë OSHEE sh.a, në shumën 6,996 lekë, sipas vlerës kontabël neto të datës 31.03.2018.

2. Paraqitjen e këtij vendimi për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë OSHEE sh.a.

3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë OSHEE sh.a. për paraqitjen e këtij vendimi për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë dhe ndjekjen e të gjitha procedurave për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKQYRËS
ILIR BEJTJA

ENTELA ÇIPA
ANËTAR

AGIM BREGASI
ANËTAR

OSHEE SH.A. - OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE
OSHEE, sh.a.
Sekretaria
Nr. 002

TOMMY KOLA
ANËTAR

ENEA KARAKAÇI
ANËTAR

ENTON DURO
ANËTAR

OSHEE SH.A.

RAPORT ZVOGELIM KAPITALI

Raport i përgatitur nga
Auditues Ligjor
Elton Tirana

Tiranë
26 Prill 2018

ELTON TIRANA
LICENSE NR. 257

OSHEE sh.a.
Sekretaria
Nr. 002

PËRMBAJTJA

1. Raporti I Audituesit të Pavarur

OSHEE, sh.a.
Sekretaria
Nr. 002

ELTON TIRANA
LICENSE NR. 267
EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR

Raport i Audituesit të Pavarur
Për Zvogëlimin e Kapitalit të Regjistruar
të Shoqërisë
"OSHEE Sh.a."

Drejtuar: MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

SHOQËRISË "OSHEE Sh.a."

TIRANË

Me cilësinë e Audituesit Ligjor, të caktuar me Vendimin nr. 2263/2 datë 16.02.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqes Raportin e kërkuar për Zvogelimin e Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë "OSHEE Sh.a" bazuar sa më poshtë:

Baza Ligjore për realizimin e këtij misioni është:

- Ligji Nr. 7850 datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"
- Ligji Nr. 9228 datë 29/04/2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar
- Ligji Nr. 10091 datë 05/03/2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9723 datë 05/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar
- Vendimi Nr. 2263/2 datë 16/02/2018 i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë

Përgjegjësia ime si Ekspert i Pavarur është të shpreh një Opinion mbi Zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë "OSHEE Sh.a." duke respektuar ligjet sa më sipër dhe duke deklaruar pavarësinë nga

ELTON TIRANA
LICENSE NR 267

OSHEE, sh.a.
Sekretaria
Nr. 002

Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme dhe të rregulluara sipas ligjit për profesionin e Ekspertit Kontabël.

Deklaroj sa më sipër se kam përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa dhe besoj se evidenca e dhënies së sigurisë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Organeve të Qeverisjes per Pasqyrat Financiare

Përgjegjësia e drejtimit të Shoqërisë "OSHEE Sh.a" është: Përgatitja dhe paraqitja e drejtë e deklarimeve financiare, deklarimeve juridike dhe informacioneve të tjera të domosdoshme për dhënien e sigurisë për procesin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Dhënien e një Opinioni mbi Zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë "OSHEE Sh.a"

Përgjegjësia ime si Ekspert i Pavarur është të shpreh një Opinion mbi Zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë "OSHEE Sh.a." për vlerat të dala si rezultat i:

- Nxjerrjes nga Inventari i Aseteve të Shoqërisë i Kabinës Elektrike "Dajti 1" në Rr. Kongresi i Manastirit, Tiranë.

Shoqëria "OSHEE Sh.a" është regjistruar në datën 10/12/2007 si Shoqëri Aksionare, me seli Blv. "Gjergj Fishta", Nd. 88, H. 1, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, me kapital të regjistruar deri në datën e hartimit të këtij Raporti në vlerën **29,936,715,996 ALL**, me aksioner të vetëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është "Të ofrojë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes për fushat e mëposhtme të mbuluara: kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejt të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar, duke përfshire, por pa u kufizuar në: ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e kësaj të fundit për klientët, etj.

Raporti i përgatitur për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë mbështetet ne shkresen Nr.7448 prot date 23/04/2018 te OSHEE mbi kontabilizimet e bera gjate vitit 2017 dhe dokumentacioni justifikues i raportit te vleresimit te asteve dhe shkreses mbi raportin e zvogelimit te kapitalit pergatitur nga Audituesi Ligjor Bujar Bendo ne daten 06.04.2018 . Pasqyrat financiare te vitit 2017 jane te proces mbylljeje dhe auditimi.

ELTON TIRANA
LICENSE NR. 257
EKSPERT KONTABEL TE REGJISTRUAR

OSHEE sh.a.
Sekretaria
Nr. 002

1. **Zvogëlim i Kapitalit të Shoqërisë "OSHEE Sh.a"**

Në zbatim të Vendimit Nr. 2263/2 datë 16/02/2018 i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitali i Shoqërisë zvogëlohet për vlerën e asetit asetetit Kabina Elektrike "Dajti 1" ne rrugen Bajram Curri.

Zvogëlimi i Kapitalit për:

1. Vlera e asetit të Kabinës elektrike "Dajti 1"

Shoqëria disponon:
Certifikate per vertetim Pronësie Nr.1725295 me te dhenat si me poshte:
Numri i pasurise 3/86-K1 Volumi 40 faqe 55 ne zonen kadesurale n\Nr.8140, Truall dhe ndertese 18m²

Në kontabilitetin e Shoqërisë ky aset është i regjistruar si toke dhe Ndertese. Identifikimi ne kontabilitetin e shoqerise me emertimin "Toka-Kabina murature,Bll.Dajti-1" me numer identifikimi 311010005922 me vlere te fillestare 6,799.58 dhe vlere te rivleresuar dhe te mbetur 6,800 Leke. Identifikimi ne kontabilitetin e shoqerise me emertimin "Ndertese- Kabina murature,Bll.Dajti-1" me numer identifikimi 211010002080, me vlere te rivleresuar 18.000Leke sipas (Raport Per Rivleresimin e Aseteve te Shoqerise "OSHEE" SH.A Tirane). Sipas shkreses se Departamentit Ekonomik te OSHEE deri me daten 31/03/2018 jane njohur amortizim 2,888.44 Leke dhe vlere e mbetur 15,111.56 Leke.

Ne total kapitali i shoqerise do te zvogelohet per efekt rrumbullakimi 6,996 Leke dhe diferenca 196 Leke kalon ne zerin rezerva te tjera, Gjithashtu vlera 15,111.56 Leke do zvogeloje zerin rezerva rivleresimi dhe amortizimi do te rimerret.Ne kontabilitetin e shoqerise ky veprim do te pasyrohet si me poshte:

Kreditim te llogarise " Aktive afatgjata material" ne zerin Toka per 6,800 Leke
Kreditim te llogarise " Aktive afatgjata material" ne zerin Ndertesa per 18,000 Leke
Debitim te llogarise "Amortizim i akumuluar" per 2,888.44 Leke
Debitim te llogarise " Kapital i regjistruar" per 6,996Leke

Debitim te llogarise " Rezerva rivleresimi" per 15,111.56 Leke
Kreditim te llogarise "Rezerva te tjera" per 196 Leke

Ne perfundim kapitali i shoqerise do te zvogelohet me 6,996 Leke .

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë "OSHEE Sh.a" pas zvogëlimit është 29,936,709,000 Lekë i cili perbehet nga 29,936,709 aksione me vlere nominale 1,000 Leke secila. Ky Kapital zoterohet 100% nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

ELTON TIRANA
LICENSE NR. 287

OSHEE, Sh.a.
Sekretaria
Nr. 002

STUDIO TIRANA
A. Sh. Gjeneral e Pavarësisë, Pall. Kika 1, Ap. 8/2, Tirana-Albania
AUDITING & RELATED SERVICES ACCOUNTING BUSINESS CONSULTING & TAX ADVICES REAL ESTATE APPRAISER

KAPITALI	ISHTE	NDRYSHIMET	BEHET
Kapitali aksionar	29,936,715,996	-6,996.00	29,936,709,000
Totali i kapitalit	**29,936,715,996**	**-6,996.00**	**29,936,709,000**

Në përfundim të misionit që më është caktuar duke kryer të gjitha ekzaminimet e nevojshme, pasi u verifikuan të gjitha procedurat për zvogëlimin e kapitalit, raportoj se misioni është plotësuar sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Sipas opinionit tim janë zbatuar të gjitha kërkesat e Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Ligjit Nr. 9723 datë 05/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar për ndryshimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Ky raport u përpilua në 4 (katër) kopje të njëjta.

Auditues Ligjor

Elton Tirana

Tirane 26/04/2018

ELTON TIRANA
LICENSE NR. 257
EKSPERT KONTABEL TE REGISTRUAR

OSHEE, sh.a.
Sekretaria
Nr. 302

Zvogëlimi i kapitalit te nënshkruar me transferimin e AAM-ve
nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëria OST sh.a.

Drejtuar: Asamblesë së Aksionerit të vetëm "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë" të shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha",
Ministrit z.Damian Gjiknuri

Administratorit z.Adrian Çela

Lënda: Raport për zvogëlimin e kapitalit te shoqërisë "Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a."

Te nderuar Zotërinj,

Aksioneri i vetëm i shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjise Elektrike sh.a." (OSHEE sh.a.), me ka emëruar si ekspert për hartimin e raportit te zvogëlimit të kapitalit te shoqërisë, me vendim Nr.1320/4, datë 03/03/2017. Zvogëlimi i kapitalit te shoqërisë, do të kryhet me vlerën e transferimit të aseteve të shoqërisë OSHEE sh.a. me përfitues shoqërinë OST sh.a.

Me cilësinë e Audituesit Ligjor, me license nr. 79, dt.12.04.2000, te lëshuar nga IEKA, për kryerjen e ketij angazhimi jam mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare.", i ndryshuar, Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, Ligjin Nr.43/2015 "Për sektorin e Energjise Elektrike", neni 16, pika 3, germa "m", Statutin e OSHEE sh.a, neni 20, pika 20.2/20.3, Vendimin e Këshillit Mbikqyrës së OSHEE sh.a. Nr.18, datë 10/05/2016, Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar dhe legjislacionin fiskal ne fuqi.

Bazuar në verifikimet dhe proçedurat e kryera, rezulton se zvogëlimi i kapitalit të nënshkruar është për shumën 146,633,004 leke, sipas vlerës kontabël neto në datë 31/03/2018 të listës së aseteve (AAM-ve) të propozuara nga OSHEE sh.a.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor

BUJAR BENDO E.K.R TIRANA-ALBANIA

Tirane me, 06/04/2018

OSHEE, sh.a. Sekretaria Nr. 692

1. Te përgjithshme

Shoqëria OSHEE sh.a, është person juridik i krijuar në datë 08/06/2007, ne vijim te VKM-se Nr. 862, datë 20/12/2006, dhe regjistruar si shoqëri aksionere me Vendim nr. 38587, datë 19/06/2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Selia e shoqerisë është në adresën: Njësia Administrative Nr. 7, Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H. 1, 1023, Tirane.

OSHEE sh.a. zotërohet 100% nga aksioneri Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Administrator i shoqerisë është z. Adrian Çela.

Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është të ofrojë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes për fushat e mëposhtme:

a. Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, me tarifa të rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licensën e akorduar;
b. Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejt të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licensën e akorduar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
   - ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve;
   - lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe
   - instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike.
c. Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe bazuar në ndryshimet rajonale apo territoriale të kërkesës;
d. Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shoqeria është regjistruar pranë Drejtorise Rajonale Njesia e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, me NIPT K72410014H

OSHEE sh.a. është regjistruar me kapital fillestar 2,000,000 leke. Ndryshimi i fundit, sipas ekstraktit te QKB-së është në datën 20/12/2016, ku vlera e kapitalit të regjistruar të shoqerisë është 30,083,349,000 leke.

OSHEE sh.a. Sekretaria Nr. 002

Ndryshimet në kapitalin e regjistruar nga data e krijimit deri në datë 20/12/2016, paraqiten në tabelën në vijim:

Nr	Data e regjistrimit	Procedura	Kapitali i nënshkruar	Efektet e ndryshimit (+/-)
1	10/12/2007	Kapital fillestar	2,000,000	2,000,000
2	27/03/2008	Rritje kapitali	20,841,227,000	20,839,227,000
3	29/05/2008	Rritje kapitali	22,745,663,000	1,904,436,000
4	02/09/2008	Zvogëlim kapitali	15,833,146,000	(6,912,517,000)
5	17/09/2008	Zvogëlim kapitali	15,778,733,906	(54,412,094)
6	23/10/2008	Rritje kapitali	22,665,020,000	6,886,286,094
7	29/05/2009	Rritje kapitali	30,099,101,000	7,434,081,000
8	20/12/2016	Zvogëlim kapitali	30,083,349,000	(15,752,000)

2. Proçedura të kryera për zvogëlimin e kapitalit

Për të përgatitur, Raportin për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, jam mbështetur në verifikime të bëra në dokumentat si më poshtë:

- Ekstrakti historik dhe të dhënat e regjistrimit të shoqerisë pranë QKB-së, e identifikuar me NIPT K72410014H;
- Statutin e Shoqërisë, datë 12/11/2014;
- Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur në datë 31 dhjetor 2016 dhe raportin e auditimit përkatës të datës 20/07/2017, miratuar nga Aksioneri i vetëm, me vendimin Nr.667/3 prot., datë 20/12/2017;
- Proçes verbalet e inventarëve fizikë të AAM-ve të transferuara me datë 31/03/2018, bazuar në shkresën me Nr.3391 prot., datë 14/06/2017 të OST sh.a. dhe shkresën me Nr.25681, datë 23/11/2017, të OSHEE sh.a. për ngritjen e komisioneve te përbashketa për transferimin e AAM-ve;
- Llogaritë kontabile të kapitalit të nënshkruar, AAM-ve dhe sistemimet përkatëse deri në datë 31/03/2018, bazuar në vlerat kontabël të regjistruara dhe dokumentit të përbashket te marrjes në dorëzim nga palet;
- Te tjera evidenca dhe dokumenta mbështetese në formë elektronike dhe të shkruara, të gjykuara të nevojshme gjatë procedurës dhe në hartimin e ketij raporti.

OSHEE sh.a. Sekretaria Nr. 602

3. Kapitalet e veta para zvogëlimit

Në datën e ketij raporti shoqëria nuk ka përfunduar ende pasqyrat financiare për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2017. Ne tabelën në vijim paraqitet gjendja e kapitaleve të veta të analizuara sipas zërave kontabël, bazuar në Pasqyrat Financiare të miratuara për vitin e mbyllur në datë 31 dhjetor 2016.

Kapitalet e veta	31/12/2016	31/12/2015
Kapitali i nënshkruar	30,083,349	30,099,102
Rezerva Rivlerësimi	1,513,463	0
Rezerva te tjera	2,916,011	2,916,011
Fitim/(humbje) e mbartur	(88,770,269)	(104,263,468)
Fitim/humbje te ushtrimit	18,719,939	15,495,200
Total Kapitalet e veta	**(35,537,507)**	**(55,753,155)**

Sic theksuam dhe me lart në kete raport, kapitali i nënshkruar i shoqërisë është ne vlerën 30,083,349 leke, pas ndryshimit të fundit datë 20/12/2016. Drejtimi i shoqerisë deklaron se nuk kanë vendimarrje të tjera apo levizje me efekte në zërin e kapitalit te nënshkruar, përveç sa figuron e regjistruar edhe në ekstraktin historik në QKB.

Shoqëria ka kryer në vitin 2016, proçesin e rivlerësimit të AAM-ve, i cili ka sjelle krijimin e rezervës së rivlerësimit për shumën 1,513.463 mije leke, të paraqitur në postin Rezerva Rivlerësimi.
Vlera e përcaktuar nga diferenca midis amortizimit të llogaritur në vlerën e rivlerësuar të aktivit, me amortizimin e llogaritur ne koston fillestare te tij, tranferohet nga zëri rezerva rivlerësimi tek fitimi i pashpërndarë, ne fund te cdo periudhe, kur aktivi perdoret nga shoqëria. Në rast se një aktiv afatgjatë material çregjistrohet atëherë vlera e paraqitur në rezerva rivlerësimi për këtë aktiv, transferohet në fitimin e pashpërndarë, sipas SNK 16, paragrafi 41.

SNK 16, paragrafi 41

"Teprica e rivlerësimit e përfshirë në kapitalin neto në lidhje me një zë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të transferohet drejtpërdrejt tek fitimi i pashpërndarë nëse aktivi nuk njihet (çregjistrohet). Kjo mund të përfshijë transferimin e gjithë tepricës nëse aktivi tërhiqet ose nxirret nga përdorimi. Megjithatë, një pjesë e mbivlerës mund të transferohet kur aktivi përdoret nga njësia ekonomike; Në një rast të tillë madhësia e tepricës së transferuar do të jetë diferenca mes amortizimit të bazuar në vlerën kontabël (neto) të rivlerësuar të aktivit dhe amortizimin e bazuar në koston fillestare të aktivit. Transferimi nga teprica (mbivlera) e rivlerësimi tek fitimi i pashpërndarë nuk bëhet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

OSHEE sh.a. Sekretaria Nr. 002

Zvogëlimi i kapitalit te nënshkruar me transferimin e AAM-ve
nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëria OST sh.a.

Duke qënë se kam marrë nje listë të AAM-ve ku paraqitet, kosto e rivlerësuar dhe amortizimi i akumuluar deri ne datën 31 mars 2018, njedhimisht nuk kam informacion mbi amortizimin e llogaritur në koston fillestare, unë nuk do të shprehem në këtë raport lidhur me veprimet dhe vlerat kontabile qe pasqyrojnë transferimin e AAM-ve, për postin rezerva nga rivlerësimi dhe fitimi i pashpërndarë.

Në këtë raport duke ju përmbajtur objektit dhe detyrës së vendosur nga Aksioneri, bazuar në verifikime në dokumenta ligjore dhe kontabile, do të shprehet vlera me të cilën zvogëlohet kapitali i nënshkruar i shoqërisë nga transferimi i AAM-ve, pjesë e sistemit 110 kV.

4. AAM-të e transferuara

Ne vijim te Vendimit Nr.1320/4, datë 03/03/2017, pika 1, për miratimin e transferimit të AAM-ve, nga shoqëria OSHEE sh.a. me përfitues shoqërine OST sh.a, sipas listes se propozuar nga OSHEE sh.a., te dyja shoqërite ngritën grupe pune, për verifikimin fizik të AAM-ve, të vendosura ne Rajonin Jugor dhe Rajonin Verior. Grupet e punës te ngritura per kete qëllim, kryhen se bashku, verifikimin fizik të AAM-ve dhe mbajtën proces verbale te cilët përfunduan dhe u firmosën nga të gjithë anëtaret e grupeve te përbashketa, ne datë 31/03/2018.
Vlen te theksohet fakti që për bashkrendimin e punës në inventarizimin dhe marrjen në dorëzim të AAM-ve, është humbur kohe, pasi me parë secila palë ka punuar dhe ka inventarizuar veçmas këto AAM.

Nga inventari fizik rezultuan 413 copë artikuj, të cilët nuk u identifikuan ne inventarin kontabël te shoqërisë OSHEE sh.a. Drejtoria Teknike dhe Drejtoria Ekonomike e shoqerisë OSHEE sh.a., për mungesen e 413 artikujve, paraqiten gjykimin dhe komentin e tyre, se në kontabilitetin e OSHEE, këto artikuj paraqiten te bashkuar, në nënstacionet dhe paisjet e transferuara.

Gjykimi i tyre bazohet në argumentin se këto AAM, figurojnë te tilla, që nga krijimi i OSHEE sh.a. dhe janë AAM të transferuara nga KESH sh.a. të cilat në inventarizim u morën me përshkrimet sipas librave kontabël te KESH, te emërtuara në grupe te bashkuara, pa kodbare dhe pa njësi të shprehura dhe u kontabilizuan si të tilla.

Ne përfundim, nisur nga fakti që vlera e treguar në kontabilitet është e plotë, palët u dakortësuan që artikujt e identifikuar veçmas të merren në kontabilitet, për efekt identifikimi dhe inventarizimi me vlerën 1 leke.
Pas përfundimit të inventarit fizik dhe rakordimit me inventarin kontabël, vlera e AAM-ve të kategorisë makineri e paisje, që do të tranferohen, do të jetë vlera kontabël neto në datën 31/03/2018, prej 146,633,004 leke.

OSHEE, sh.a. Sekretaria Nr. 002

5. Zvogëlimi i kapitalit te nënshkruar

Pas verifikimit të proçes verbalit të marrjes në dorëzim nga OST sh.a., të AAM-ve të tranferuara nga OSHEE sh.a. dhe dokumentacionit bashkangjitur ketij proces verbali, shoqëria OSHEE sh.a. mund të proçedojë me zvogëlimin e kapitalit të nënshkruar për vlerën 146,633,004 leke.

Transferimi i AAM-ve, do të shoqërohet me faturë tatimore shitje nga OSHEE sh.a. për OST sh.a. Proçesi i transferimit të AAM-ve, nuk është jashtë fushës së zbatimit të TVSH-se, pasi nuk plotëson kushtet e transferimit të veprimtarisë ekonomike, sipas përcaktimit në nenin 16, të Ligjit NR. 92/2014 Për TVSH. Theksojmë se shoqëria OST sh.a. do të paguaj nga fatura e shitjes vlerën e TVSH-së për shoqerine OSHEE sh.a., pasi vetëm vlera e AAM-ve pa TVSH, është pjesë e vlerës së kapitalit të nënshkruar në këtë proçes.

Veprimet kontabël për transferimin e AAM-ve dhe zvogëlimin e kapitalit te nënshkruar, në librat e OSHEE, paraqiten si më poshte:

- **Regjitrimi i fatures se shitjes**

Llogaria	Vlera në debi	Vlera në kredi
Klient OST	175,959,605	
Të ardhura nga shitje AAM		146,633,004
TVSH në shitje		29,326,601

- **Cregjistrimi i AAM-ve**

Llogaria	Vlera në debi	Vlera në kredi
Kosto e rivlerësuar AAM		219,437,999
Amortizimi i akumuluar	72,804,995	
Të ardhura nga shitje AAM	146,633,004	
Fitim (humbje) nga shitje AAM		-

- **Zvogëlimi i kapitalit sipas marrëveshjes së transferimit te AAM-ve**

Llogaria	Vlera në debi	Vlera në kredi
Kapitali i nënshkruar	146,633,004	
Klient OST		146,633,004

OSHEE, sh.a. Sekretaria Nr. 002

Bashkëlidhur këtij raporti është lista e AAM-ve me 1,840 artikuj të transferuar të cilët përbëhen nga 1,878 cope, me vlerë 146,633,004 leke. Lista e AAM-ve, do të vihet në dispozicion edhe në versionin elektronik në formatin excel..

6. Pjesëmarrja në Kapitalin e shoqërisë

Në mbështetje të ekstraktit të QKB-se, dhe dokumentave të tjerë ligjore, aksioner i vetëm dhe zotërues 100 % i kapitalit të shoqërisë është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Aksioneri	Kapitali i nënshkruar	Përqindja e zoteruar	Nr aksioneve	Vlera nominale
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	30,083,349,000	100%	30,083,349	1,000

Pas zvogëlimit të kapitalit të nënshkruar të shoqerisë, për vlerën e transferimit të AAM-ve nga grupi makineri e paisje me vlerë 146,633,004 leke vlera dhe numri i aksioneve, do të ndryshojë si më poshtë:

Aksioneri	Kapitali i nënshkruar	Përqindja e zoteruar	Nr aksioneve	Vlera nominale
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	29,936,715,996	100%	29,936,716	1,000

OSHEE, sh.a. Sekretaria Nr. 602

